



Pranuar / Dorezuar Priljevoj / Prodato Received / Delivered	09.10.2023	3	viti god year
Organ / Njesia Organ / Jedinica Org. / Unit	Nr Prot Br Prot Prot. No	Shtypja Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKUMSHICK	6428/2023		1/1



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr. 1083/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Jeton Koca dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1083/2023 të datës 02.10.2023 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi: kundër organit të punësimit Komuna e Podujevës, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 06.10.2023, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.1083/2023 e datës 15.08.2023 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Nëpunësi civil (tani e tutje ankuesi), i punësuar në Komunën e Podujevës, më datë 02.10.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër heshtjes administrative të organit punëdhënës lidhur me kërkesën e ankuesit për kompensim në mënyrë retroaktive të mjeteve të papaguara në emër të diferencës së pagës në mes të pozitës Profesional 1 (koeficient 5.66) dhe asaj Auditor i Brendshëm (koeficient 6) për muajt shkurt, mars, prill dhe maj të vitit 2023 si dhe kompensimin e shtesës transitore të posaçme sipas dispozitave të nenit 41 paragrafi 2 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 17.08.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komunën e Podujevës, ndërsa kjo e fundit më datë 24.08.2023 ka përcjell shkresat ndërlidhur më çështjen në këtë procedurë të shqyrtimit.

Sipas kërkesës së Kryetarit të Kolegji, duke u mbështetur në aktet e brendshme normative me datë 25.09.2023 Kryetari i Këshillit ka nxjerrë Vendimin VK/2023 me numër protokolli: 6244/2023 përmes të cilit vendim ankesës së ankuesit A.nr.1083/2023 të datës 15.08.2023 ia ka vazhduar afatin e vendimmarrjes edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 567/2023 të datës 15.08.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; E-mailin e datës 15.08.2023 dërguar në Këshill nga ankuesi; Akt emërimit të ankuesit të datës 08.02.2022 me shifër AE.nr.13-111/01-009334/22; Kërkesën e ankuesit të datës 05.07.2023 dërguar në Njësinë e Burimeve Njerëzore të Komunës së Podujevës; Vendimin e Qeverisë së republikës së Kosovës të datës 16.02.2023 me listën e koeficienteve të pagave sipas ligjit të ri; Shkresën e datës 03.12.2010 të Sekretarit të Përhershëm të MAPI-it me listën e përcaktimit të koeficientit për pozitën Auditor i Brendshëm; Konkursin e datës 04.02.2021; E-malin e datës 03.10.2022 dërguar nga për ankuesin; E-malin e datës 01.10.2022 dërguar nga për E-malin e datës 30.09.2022 dërguar nga për E-malin e datës 23.09.2022 dërguar nga për ankuesin; Kërkesën e ankuesit të datës 06.09.2023 me formularin e bashkangjitur; Kopjen e letërnjoftimit të ankuesit; Konkursin e datës 30.04.2021; Konkursin e datës 08.02.2021; Konkursin e datës 20.07.2022; Konkursin e datës 27.10.2021; 30.08.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 17.08.2023; Përgjigjen në kërkesë e datës 24.08.2023; Konkursin e shpallur me datë 24.06.2021 nga Komuna e Podujevës; Kërkesën e ankuesit të datës 07.05.2023; Listën e pagave të ankuesit për muajt janar, shkurt, mars, prill, maj, qershor dhe korrik të vitit 2023; Listën e datës 01.06.2023 lidhur me ekuivalentimin e koeficienteve të pagave; Kërkesën e ankuesit të datës 03.01.2023; Përgjigjen e Njesisë së Burimeve Njerëzore e datës 14.03.2023; Zarin posta me shifër: R2926261.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave nga analizimi i shpresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurës, konstatoi se ankesa e ankuesit është e palejuar, sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave nga provat e administruara të lëndës ka gjetur se ankuesi sipas Akt Emërimit me shifër: AE.Nr.13-111/01-0009334/22 të datës 08.02.2022 është i punësuar në Komunën e Podujevës dhe se i njëjti mban pozitën "Auditor i Brendshëm". Po ashtu, Kolegji i Këshillit duke u bazuar në të njëjtin akt emërim të datës 08.02.2022, ka gjetur se ankuesi fillimisht është emëruar me koeficientin e pagës tetë (8) në pozitën e punës "Auditor i Brendshëm" sipas konkursit të shpallur të datës 24.06.2021 nga Komuna e Podujevës në të cilit konkurs për pozitën në fjalë ishte parapa koeficienti tetë (8).

Po ashtu, Kolegji i Këshillit sipas listës së pagave me kodin:10-16005-6150111 të periudhës kohore janar-korrik të vitit 2023 ka konstatuar se ankuesi pavarësisht hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, nga muaji shkurt e deri në muajin qershor 2023 ishte paguar sipas vlerës së koeficientit (5.66 Profesional 1) i cili është në ekuivalencë me koeficientit e tetë (8), kurse Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Komunës së Podujevës me datë 15.05.2023 me kërkesë i është drejtuar Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik për korrigjimin e koeficientit të ankueses, ndërsa me pas ankuesit sipas listës së datës 01.06.2023 i është korrigjuar koeficienti duke u përcaktuar bërë gjashtë (6) sikurse përcaktohet me Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë-Shtojca14.2, pozita Auditor i Brendshëm, klasa E15-koficienti 6 dhe si rrjedhojë

ankuesi nga muaji qershor ka filluar të paguhet sipas ligjit të ri për paga lidhur me pozitat e Auditorëve të Brendshëm.

Tutje, ankuesi me datë 05.07.2023 i ishte drejtuar Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Komunës së Podujevës me kërkesë për kompensim në mënyrë retroaktive të mjeteve të papaguara në emër të diferencës së pagës në mes të pozitës Profesional 1 (koeficient 5.66) dhe asaj Auditori të Brendshëm (koeficient 6) për muajt shkurt, mars, prill dhe maj të vitit 2023 si dhe kompensimin e shtesës transitorë të posaçme sipas dispozitave të nenit 41 paragrafi 2 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, ndërsa për shkak të heshtjes së institucionit me datë 15.08.2023 ka parashtruar ankesë në Këshill me pretendimet ankimore të pasqyruara sikurse në arsyetimin e këtij vendimi.

Kolegji i Këshillit lidhur me pranueshmërinë e ankesës së ankueseve, ka analizuar dispozitat ligjore të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, gjegjësisht nenin 98 paragrafin 1 dhe 2, ku përcaktohet se: *1. Procedura administrative nisur sipas kërkesës, do të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se sa afati i përcaktuar me ligj të veçantë për atë lloj procedure. 2. Në rast se ligji i veçantë nuk ka paraparë një afat, siç është paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, afati i përgjithshëm i zbatueshëm për përfundimin e procedurës administrative është dyzetepesë (45) ditë nga fillimi i saj*", si dhe nenin 127 paragrafi 1 dhe 4 i të njëjtët ligj ku përcaktohet se: *"1. Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ. 4. Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ.*

Ndërlidhur me këtë, Kolegji i Këshillit në bazë të shkresave të lëndës si dhe konstatimeve të dhëna si më lartë në arsyetimin e këtij vendimi, konstaton se ankesa e ankuesit e datës 15.08.2023 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është e paraafatshme, ngase e njëjta është parashtruar në kundërshtim me nenin 127 paragrafi 1 dhe 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, pasi që institucioni punëdhënës lidhur me kërkesën e ankuesit të datës 05.07.2023 ende nuk kishte vendosur apo nuk ka nxjerrë akt administrativ përpara se ankuesi të parashtrojë ankesë në Këshill, sikurse që nuk është përmbushur as kriteri kohor ndërlidhur me heshtjen administrative, pasi që institucioni punëdhënës sipas dispozitave të lartcekura ligjore ka pasur afat kohor *dyzetepesë (45) ditë* për trajtimin e kërkesës së ankuesit të datës 05.07.2023, ndërsa ankuesi ankesën në Këshill e ka parashtruar me datë 15.08.2023 apo *dyzetënjë (41) ditë* pas parashtrimit të ankesës në institucion punëdhënës.

Andaj, Kolegji për Shqyrtimi de Vendosjen e Ankesave, nga të gjeturat e dhëna si më lartë, konstaton se ankesa e ankuesit e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 15.08.2023 është parashtruar në kundërshtim me nenin 127 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, andaj është hedhur poshtë si e palejuar si në dispozitiv të këtij vendimi pasi që nuk e plotëson kushtin e nevojshëm të pranueshmërisë së ankesës në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *"Ankesa është e pranueshme nëse i plotëson këto kushte: 1.3. ajo është parashtruar brenda afatit të parashikuar nga neni 127 i këtij ligji."*

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1083/2023

Flakron GASHI

Zyrtarë i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Udhëheqësit të Personelit të Komunës së Podujevës, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së;

